

E Mërkurë, 25 Dhjetor 2013

BALLINA POLITIKA NACIONALE EKONOMIA BOTA &amp; RAJONI SPORT ROZË ARTE OPINIONE SHKURTESHQIP LOJËRA

Lyp

Film | Teatër | Libri | Expo | ExpressBook | Muzikë | TV

## "NET-RRJET", TEJKALON FORMËN TRADICIONALE TË ARTIT



Nga Express | 11 Dhjetor 2013 11:08

Madhësia e tekstit: A A

Në edicionin e pestë të ekspozitës ndërkombëtare "Net/Rrjet" janë ekspozuar vepra të ndryshme të artistëve bashkëkohor ndërkombëtarë dhe vendorë. Instalacionet e ndryshme kanë zgjuar kureshtjen e të pranishmëve, qofshin ata nga komuniteti i artit apo qytetar të rëndomtë.

Vepra të ndryshme arti, kryesisht instilacione prej më të ndryshmeve, janë ekspozuar të martën në mbrëmje në galerinë e Fakultetit të Arkitekturës së Universitetit të Prishtinës, teksa është hapur ekspozita ndërkombëtare "Net/Rrjet".

Në edicionin e pestë të kësaj ekspozite janë paraqitur fotografi, instilacione, video, të cilat në njërin apo në formën tjetër e kanë dhënë një mesazh ndryshe nga ato që i japin veprat tjera artistike.

Ekspozita, si e tillë ka sjellë në Prishtinë punimet e artistëve nga shumë vende perëndimore, por jo edhe artistët të cilët nuk kanë qenë të pranishëm. Sidoqoftë, Anila Shapalaku, Antigona A. Selmani, Artur Muharremi, Dushan Zidar, Gerhard Schabel, Thomas Heiber, Markus Peter, Rrezeart Galica, Ventsislav Zankov, Verica Kovačevska, dhe Mirjam Burgin, janë artistët e përzgjedhur nga juria e ekspozitës, punimet e të cilëve janë prezantuar në ekspozitë.



Ekspozitë me karakteristika të veçanta

### TË TJERA NGA RUBRIKA

12 artistë përzgjidhen mes 130, për çmimin e madh "Onufri"

Çmimi "Onufri" është...



0

Malësia e vitit 1932-1938 në objektivin e fotografit Shan Pici, nga "Marubi" në Muzeun Kombëtar

Fototeka kombëtare...



0

Publikohet katalogu i ekspozitës "Imazhi gjuhësor..."

Zyrtarët e Galerisë së...



2

"Një hap përpara, dy hapa prapa", drejt Prishtinës

Hannah Weinberger në bashkëpunim me...



0

### TË TJERA

#### POLITIKA

Rexhepi Bosnjës: Aman hiqni vizat

Emilia Rexhepi, deputete boshnjake...



1

#### RAJONI

Nuk shlyen kredinë, nxirren në ankand tetë pasuri të Rezart Taçit

Rreth tetë prona, që janë të...



1

#### FUTBOLL

Kurrë në Lazio

Emri i Paolo Di Canios ishte...



0

#### BOTA

Terroristët paralajmërojnë futjen e helmit nëpër lëngje

Një pako me përmbajtje të...



1

Organizatorja e kësaj ekspozite, Majlinda Kelmendi, në hapje të saj ka thënë se ekspozita e paraqet një anë tjetër të artit, e cila, ka një mesazh të caktuar. Ajo ka thënë shkurtimisht se ekspozita tregon për komunikimet në mes të personave, për kohën që personat shpenzojnë në "botën virtuale" si dhe për kreativitetin e artistit.

Ndërkaq, bashkëkuratorja e saj, ZeniBallazhi, gjatë një bisede për "Kultplus" thotë se ekspozita ka të bëjë me paraqitjen e artit bashkëkohor. "Mediumet të cilat paraqiten në këtë ekspozitë apo karakteristikë të veçantë që e bënë këtë ekspozitë është mënyra e paraqitjes së këtyre veprave, apo do të thosha i këtyre eksperiencave të ndryshme të cilat vijnë nga vende të ndryshme", thotë ai.

Ballazhi thotë se veprat e ekspozuara në këtë ekspozitë janë forma të reja të artit. "Në një realitet sot ne nuk mund të shfaqim vetëm pjesë nga metodat e vjetra dhe tradicionale, dhe jemi munduar të paraqesim artistë të cilët reagojnë në mënyrë mjaftë proporcionale, të cilët kanë shfrytëzuar teknologjinë", tregon njëri nga organizatorët e ekspozitës, i cili gjithashtu është artist vizuel me profesion.

Me pleksiglas "zhdukën" mitet për të mençurit

Një punim i punuar nga pleksiglas (plastika transparente), nga artistja Antigona A. Selmani, ka treguar një anë tjetër të artit, e cila, ka një mesazh të caktuar. Ajo ka thënë shkurtimisht se ekspozita tregon për komunikimet në mes të personave, për kohën që personat shpenzojnë në "botën virtuale" si dhe për kreativitetin e artistit.

Харесва ми 8+1 105 Follow

fillojnë nga përtreti më i vogël dhe përfundon tek ai më i madhi.

Por, çka ka dashur të thotë autorja me këtë vepër. "Vepra quhet 'përkrahës dhe kundërshtar', dhe simbolikisht ka treguar jetën e njerëzve të shekullit njëzetën dhe mundësinë e tyre për tu shfaqur, për tu dukur, si nga ana intelektuale, ashtu edhe për ta treguar egon", thotë ajo.



KultPlus - Photo: Ridvan Slivova

Selmani, që është e diplomuar për pikturë, thotë se me veprën e saj gjithashtu ka dashur të tregojë se si teknologjia po ua mundëson sot qytetarëve gjithandaj botës që ai që është intelektual, i dijshtëm, e punëtor, të vërehet pa problem, dhe personat që si plotësojnë këto "kritere" gjithashtu të vërehen. E kundërta e kësaj situata, siç thotë ajo, ka qenë kur qytetarët "e thjeshtë" kanë krijuar bindje e mite të ndryshme për persona, pavarësisht, se suksesi i tyre dhe ajo që është thënë për ta ka qenë pikëpyetje e madhe. "Ne kemi shumë raste të intelektualëve të njohur, të idhujve tonë që me kalimin e kohës i kemi formuar, edhe kur i kemi njohur përmes rrjeteve sociale, atëherë thjeshtë jemi dëshpëruar sepse ata s'kanë qenë ata që kemi menduar që janë", thotë ajo, duke e shpjeguar mesazhin e instilacionit të saj.

Prezervativë, produkt vetëm për një përdorim

Një punim tjetër, i punuar me kompjuter dhe më pas i printuar "Online-Offline" ku shihet një prezervativ që mbahet në lartësi nga një dorë, dy cepat e së cilit krijojnë shkronjën "O", nga e cila më pas krijohet titulli i veprës "Online-Offline", është vepra artistike e autorit Rrezeart Galica.

Gjatë një prononcimi për "Kultplus" ai thotë se punimi bazohet në konceptin e ekspozitës, dhe si e tillë ka të bëjë me etikën në internet dhe teknologjinë në përgjithësi. "Ka shumë njerëz që e përdorin internetin për shumë nevoja të tyre, qofshin ato periferike, ose diçka shumë e rëndësishme, por ka edhe prej atyre që e përdorin vetëm për një çështje. Në internet na dalin informacione për të cilat ne pothuajse nuk kemi nevojë, por në fakt, prej atyre informacioneve ne mund të dalim te një tjetër punë, ide apo krijim tjetër. Punimi ironizon ata njerëz, individ që e përdorin internetin vetëm një herë. Këtu me anë të kondomit e kam paraqitur pikërisht produktin i cili është vetëm një përdorim, dhe i kam ironizuar krejt ata që internetin e përdorin vetëm për një përdorim", thotë ai.

Galica thotë se i kanë shkuar tre muaj, siç thotë ai, duke e shoshitur idenë e derisa është analizuar në një ide të vetme, përkatësisht, duke i eliminuar idetë tjera, për ta nxjerrë idenë përfundimtare "Online-Offline". /KultPlus.com

#### SHKURTESHQIP

Mendësitë e reja e të vjetra politike!

Edhe pse në fakt pluralizmi ynë politik...



0

#### POLITIKA

Krasniqi nuk e ka të sigurt votën pro buxhetit 2014

Sfidë për koalicionin qeverisës...



2

27 0 0

Препоръчва **g+1** Tweet

Shpërndaje: [in](#) [G](#) [f](#) [su](#) [v](#)

Printo Email

### Reklamoni me klik CPC

Si të reklamoni lirë dhe efikas ne portalet me të vizituar në Kosovë?

### Reklamoni me klik CPC

Si të reklamoni lirë dhe efikas ne portalet me të vizituar në Kosovë?

Komentet për këtë postim janë të mbyllura.

×

0 komente

★ 0

Të Reja ▾ Komuniteti

Shpërndaje

Identifikohu ▾

Be the first to comment.

Regjistrohu

Përdoreni Disqus në faqen tuaj



#### Intervistë me Arsim Gërxhaliu: Në Rashkë mundë të jenë varrosur së paku 250 trupa

Në Rashkë u konfirmua që ka varrezë masive. Se sa është numri i trupave që mund të qienden, si do të identifikohen ata,... **më shumë**



#### E kujt është kjo xhami?

Në lokalet e Ndërmarrjes Shoqërore "Auto-Prishtina" që drejtohet nga Islam Selimi, vëllai i deputetit të... **më shumë**

0 Shpërndaje

Komente



#### A do të heq dorë Muharem Svarqa nga nënshtetësia gjermane apo nga posti i Kryetarit të Ferizajt?

Kryetari i ri i Ferizajt Muharem Svarqa deklaroi që ka dy nënshtetësi; atë gjermane dhe kosovare. Në Gjermani



#### A do ta përmbysë gjininë femërore Tefik Ibrahim?

Ky zyrtar i AKR'së ka vendosur që ta çoi në Gjykatë Kushtetuese padrejtësinë që ia ka shkaktuar sistrer zgjedhor. Ai nuk... **më shumë**

0 Shpërndaje

Ky w ebsite kontrollon dhe menaxhohet nga Media Works. Të gjitha materialet në këtë w ebsite, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me të drejta autoriale të Media Works. Materialet në këtë w ebsite janë për shfrytëzimin personal tuajin dhe për qëllime jo-komerciale. Ato nuk mund të kopjohen, riprodhohen, ripublikohen, modifikohen, transmetohen, ose distribuohen në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të Gazetës Express. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë w ebsite ose medium tjetër, pa lejen e Gazetës Express, është shkelje e drejtave autoriale dhe është i ndaluar, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara;

Impresum

Rss Feed